



## **PARANDALIMI: KATALOG TRAJNIMI (Pjesa II)**

### **Përmbajtje**

- 3..... përmbajtje
- 4..... qëllimi i katalogut
- 6..... produktet
- 38..... Fjalor termash

### **EDUKIMI KUNDER URREJTJES**

**MODULE TRAJNIMI GJITHPËRMBLEDHËSE ONLINE PËR TË GJITHË STAFIN FE**

**FE-DETYRA E PARANDALIMIT. Një trajnim i hapur 2-ditor për zyrtarët e sigurisë**

**PËRGATITJA PËR PARANDALIM - moduli e-learning për shkollat dhe akademite**

**PËRGATITJA PËR PARANDALIM –moduli e-learning për profesionistët e shëndetit**

**PËRGATITJA PËR PARANDALIM – moduli e-learning për sektorin vullnetar**

**PËRGJIGJJA E KOMUNITETIT PËR EKSTREMIZMIN**

**KOMUNITETE TE SIGURTA NE KAMPUS**



### Qëllimi i katalogut:

1. Ky katalog është prodhuar nga Zyra Kombëtare ( Home Office) për të nxjerrë në pah disa nga kurset e trajnimit me akses publik në lidhje me Parandalimin që mund të ndihmojnë individët që përshijnë kriteret e Detyrës së Parandalimit ( Prevent Duty), të përfshira në Seksionin 26 të Ligjit Kundër Terrorizmit dhe të Sigurisë 2015. Të gjitha autoritetet e specifikuar që i nënshtrohen Detyrës, do të duhet të sigurojnë ofrimin e trajnimeve të përshtatshme për stafin e përfshirë në zbatimin e Detyrës.

2. Udhëzimi për Detyrën e Parandalimit i publikuar në mars 2015 dhe i disponueshëm në adresën [www.gov.uk/government/publications/prevent-duty-guidance](http://www.gov.uk/government/publications/prevent-duty-guidance) ofron informacion të mëtejshëm rreth sfondit të Detyrës. Strategjia e Parandalimit e publikuar në qershor 2011 është e disponueshme në [www.gov.uk/government/publications/prevent-strategy-2011](http://www.gov.uk/government/publications/prevent-strategy-2011).

3. Udhëzimi për Detyrën e Parandalimit e bën të qartë se stafi në vijën e parë që angazhohet me publikun duhet:

- Të kuptojë se çfarë do të thotë **radikalizim** dhe pse njerëzit ndoshta mund të jenë të vulnerabël për t'u tërhequr nga terrorizmi si pasojë e tij.
- Të jetë i vetëdijshëm për atë që nënkuptojnë me termin "**ekstremizëm**" dhe marrëdhëniet mes ekstremizmit dhe terrorizmit.
- Të dijë se cilat masa janë në dispozicion për të parandaluar që njerëzit të tërhiqen në terrorizëm dhe si të sfidojë ideologjinë ekstremiste që mund të lidhet me të.
- Të kuptojë si të sigurojë mbështetje për njerëzit që mund të shfrytëzohen nga ndikimet e radikalizuese.

4. Kurset në kuadër të këtij katalogu synojnë të mbështesin stafin e vijës së parë për rritjen e kuptimit, njohurive dhe ndërgjegjësimit të tyre në këto fusha.



5. Disa produkte brenda këtij katalogu janë në dispozicion pa pagesë. Të tjerë mund të kenë kosto dhe këto kosto janë specifikuar në pasqyrat e kurseve.

6. Ka një sërë kurseesh të tjera që janë gjithashtu në dispozicion që mund të mos përfshihen në këtë katalog që mund të dëshironi të merrni në konsideratë. Disa prej tyre mund të kenë qëllime më të gjera, për shembull mësimi i aftësive të të menduarit kritik për studentët. Disa kurse të mirënjohura nuk janë aktualisht në dispozicion të publikut dhe prandaj nuk përfshihen në këtë katalog.

7. Home Office synon të prodhojë një katalog të këtij lloji në mënyrë periodike. Ne do të shqyrtojmë dobinë e këtij katalogu përpara se të vendosim nëse botimet e mëtejshme të këtij katalogu do të jenë të dobishme.

#### **Proçedura:**

#### **Kurset e përfshira në katalog duhet:**

- Të jenë përgjithësisht në përputhje me politikën e Parandalimit - në termat e koncepteve që u referohen (për shembull, rreth procesit të radikalizimit)
- Të përdorin gjuhën e duhur (për shembull, mënyra më e përshtatshme për të përshkruar kërcënimin terrorist);
- Të vlerësohen si përgjithësisht efektive për qëllimin e synuar të trajnimit për Parandalimin (për shembull, cilësia e materialeve dhe trajnimit); dhe
- Të përmbushin synimet për të mbështetur stafin e vijës së parë në rritjen e kuptimit, njohurive dhe ndërgjegjësimit të tyre në fushat e përmendura në paragrafin 2 (më lart).

9. Home Office do të shqyrtojë kurset e trajnimit për t'i përfshirë në katalog. Përshtatshmëria dhe rëndësia e kurseve do të rishikohet pas çdo reagimi nga ata që kanë ndjekur kurset. Ofruesve të trajnimit mund t'u kërkohet të mbledhin reagimet nga pjesëmarrësit pas zhvillimit të kurseve të trajnimit.

#### **Mohim: Disclaimer**

Përderisa Home Office ka bërë përpjekje të arsyeshme për të vlerësuar përshtatshmërinë e ofruesve të trajnimit, kurse dhe materiale, nuk pranon asnjë detyrim në lidhje me këto kurse. Përveç siç parashikohet shprehimisht, asgjë në këtë katalog nuk ka për qëllim të krijojë ndonjë partneritet, përkatësi, asociacion ose sipërmarrje të përbashkët midis Home Office, ose ndonjë nga organizatat e renditura, të zgjedhë ndonjë organizatë të listuar si agjent i Home Office, ose



të autorizojë ndonjë organizatë të listuar për të bërë ose për të hyrë në ndonjë angazhim për ose në emër të Home Office.

## **PRODUKTE**

### **EDUKIMI KUNDER URREJTJES**

**Organizuesi:** HMG

**Qëllimi:**

Të rritet ndërgjegjësimi i sektorit të arsimit dhe i prindërve për rrezikun ndaj fëmijëve nga ekstremizmi dhe radikalizimi dhe t'u ofrojë atyre njohuri dhe burime për të ndihmuar në mbrojtjen e fëmijëve nga ky rrezik.

**Audienca e synuar:**

Prindërit, mësuesit dhe drejtuesit e shkollave

**Përshkrimi:**

Edukimi Kundër Urrejtjes është projektuar si një "ndalesë" për të pajisur mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe prindërit me aftësitë, mjetet dhe burimet që u duhen për të njohur dhe adresuar ekstremizmin dhe radikalizimin tek të rinjtë. Faqja e internetit ka katër seksione kryesore:



1. Faqja Kryesore - duke përfshirë një sërë përmbajtjesh të përbashkëta
2. Seksioni "Prindër" – ofron dhënien e këshillave mbi ndjeshmërinë dhe shenjat paralajmëruese të radikalizimit;
2. Seksioni "Mësuesi" - ofron këshilla mbi ndjeshmërinë dhe shenjat paralajmëruese të radikalizimit; trajnim në dispozicion; dhe se si të përdorim mësimet në klasë për të ndërtuar rezistencë kundër ekstremizmit;
3. Seksioni "Drejtuesi"- lidhet me këshillat përkatëse nga faqet e mësuesve dhe më pas jep këshilla shtesë mbi përgjegjësitë e shkollave nën Detyrën e Parandalimit.

Faqja e internetit ofron lidhje dhe rekomandon burimet dhe faqet e internetit të cilat janë gjykuar si të dobishme për sektorin e shkollave. Këto përfshijnë produktet aktuale të Katalogut të Praktikave më të Mira të Parandalimit dhe produktet që këshilltarët arsimorë të DfE kanë rekomanduar si të përshtatshme për zgjerimin më të gjerë.

### **Metoda e zhvillimit**

Platforma dixhitale online e promovuar përmes mediave sociale

### **Gjatësia e produktit:**

N/A

**Si të aksesoni:** Online digital platform – [www.educateagainsthate.com](http://www.educateagainsthate.com)

## **FURTHER EDUCATION COMPREHENSIVE ONLINE TRAINING MODULES FOR ALL STAFF**

### **MODULE TRAJNIMI GJITHPËRMBLEDHËSE ONLINE PËR TË GJITHË STAFIN FE**

**Organizuesi:** [The Education & Training Foundation](http://www.educateagainsthate.com)

Fondacioni i Arsimit dhe Trajnimit-Si trup që përfaqëson fuqinë punëtore të sektorit të Edukimit të Mëtejshëm (FE) Vizioni i ETF është që i gjithë mësimi të jetë me cilësi më të lartë, të arrijë rezultatet më të mira dhe të rezultojë me impaktin më të madh; dhe kjo është për të gjithë nxënësit, ofruesit, punëdhënësit, komunitetet e tyre më të gjera dhe ekonominë. Misioni i ETF është rritja e performancës dhe profesionalizmit të fuqisë punëtore të arsimit dhe trajnimit.



### **Qëllimi:**

Qëllimet e ofertës së re të mbështetjes online të ETF janë për të:

- dhënë atyre që përfundojnë modulet të kuptuarit se si zbatohet Detyra e Parandalimit në FE dhe në kuadrin e trajnimit; dhe
- lejuar përdoruesit të kontrollojnë dhe prodhojnë dëshmi të kuptueshmërisë së tyre.

### **Audienca e synuar:**

Të gjithë stafin dhe drejtuesit në FE dhe sektorin e trajnimit.

### **Përshkrim:**

I gjithë stafi trajnues i FE, drejtuesit, anëtarët e bordit dhe vullnetarët duhet të trajnohen se si të përmbushin detyrën e Parandalimit. Ofsted tashmë është duke inspektuar pajtueshmërinë dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë, siç është e qartë nga manuali i Ofsted për përdorim nga shtatori 2015.

### **Fondacioni i Arsimit dhe Trajnimit ka zhvilluar module trajnimi online për:**

- Praktikuesit;
- Staf mbështetës;
- Drejtuesit dhe Menaxherët; dhe
- Anëtarët e Bordit

Modelet e trajnimit janë në Platformën Foundation Online Learning dhe janë në dispozicion në <http://www.foundationonline.org.uk/> Stafin, drejtuesit dhe anëtarët e bordit mund të ndjekin modulet e trajnimit on-line pastaj të marrin një vlerësim. Kjo nuk duhet të zgjasë më shumë se 50 minuta në total. Nëse arrijnë 85% ose më shumë, ata do të jenë në gjendje të printojnë një Certifikatë të Fondacionit për arritje duke siguruar një dëshmi të dobishme për Ofsted ose për të tjerë. Modulet përcaktojnë kërkesat e Detyrës në FE dhe sektorin e trajnimit dhe përfshijnë raste studimi, të cilat sjellin në jetë Detyrën e Parandalimit.

Fondacioni gjithashtu ka ngritur një faqe interneti për të ofruar udhëzime, vlerësime të rrezikut, politika dhe procedura, linke me uebfaqen dhe videot. Faqja e internetit është dizajnuar në



mënyrë që përdoruesit e ndryshëm të gjejnë burimet e tyre lehtësisht. Kjo përfshin materialet të cilat mund të përdoren me studentët dhe udhëzimet për stafin dhe drejtuesit, për rolin e tyre në pajtueshmërinë me Detyrën e Parandalimit. Faqja e internetit mund të gjendet në: [www.preventforfeandtraining.org.uk](http://www.preventforfeandtraining.org.uk)

**Metoda e zhvillimit:** Përmbajtje e aksesueshme në uebfaqe

**Gjatësia e produktit:** Koha për të punuar përmes një moduli dhe për vlerësimin është 50 min.

## **FURTHER EDUCATION - PREVENT DUTY. A 2 day open workshop for safeguarding officers**

### **FE-DETYRA E PARANDALIMIT. Një trajnim i hapur 2-ditor për zyrtarët e sigurisë**

#### **Organizuesi:**

**Fondacioni i Arsimit dhe Trajnimit** - Si trup që përfaqëson fuqinë punëtore të sektorit të Edukimit të Mëtejshëm (FE) Vizioni i ETF është që i gjithë mësimi të jetë me cilësi më të lartë, të arrijë rezultatet më të mira dhe të rezultojë me impaktin më të madh; dhe kjo është për të gjithë nxënësit, ofruesit, punëdhënësit, komunitetet e tyre më të gjera dhe ekonominë. Misioni i ETF është rritja e performancës dhe profesionalizmit të fuqisë punëtore të arsimit dhe trajnimit.

#### **Qëllimi:**



Rekomandohet që Zyrtarët ekzistues të Sigurisë të marrin rolin e zyrtarit në Parandalim për kolegjet dhe ofruesit privatë në të gjithë sektorin. Qëllimi i kësaj punëtorie është të mbështesë oficerët e sigurisë në këtë shtrirje të rolit të tyre në mënyrë që ata të mund të mbështesin stafin për të marrë Detyrën e Parandalimit dhe të kuptojnë më mirë vlerat britanike të Detyrës.

**Audienca e synuar:** Zyrtarët e sigurisë në ofruesit e sektorit të FE dhe sektorit të trajnimit.

### **Përshkrim:**

Workshop “ballë për ballë” dy ditor i hapur për stafin e sigurisë në Detyrën e Parandalimit dhe integrimin e vlerave britanike në praktikën e ofruesit dhe kurrikulës. Kjo do të adresojë shqetësimet që ka stafi i sigurisë dhe i mbështet ata në zhvillimin e praktikës së tyre për të mbuluar Detyrën e Parandalimit.

### **Plan i kursit**

#### **Dita e parë:**

1. Vlerësimi i rrezikut, politikat dhe procedurat.
2. Pocesi Channel - me një Autoritet Lokal ose koordinаторit FE në Parandalim për dhënien e inpueteve dhe marrjen e pyetjeve.
3. Gjykimet profesionale për referimin
4. Çfarë ndodh kur dikush i referohet “marrjes pjesë” në Channel? Me koordinatorin e Parandalimit të Autoritetit Lokal ose FE.
5. Çfarë ndodh nëse dikush nuk pranohet në Channel? Roli i Ofruesve.
6. Raste Studimi - ndahen në hapa për të inkurajuar diskutimin për vendimet për oficerët e sigurisë, por gjithashtu duke parë atë që ka ndodhur në rastet reale por anonime.

#### **Dita e dytë:**

1. Kërkesat për trajnim stafi
2. Detyra e Parandalimit dhe pajtueshmëria
3. Vlerat britanike, sistemi baritor dhe kurrikula
4. Aftësitë e të menduarit kritik
5. Diskutime sfiduese dhe staf mbështetës në mbajtjen e diskutimeve sfiduese.

**Metoda e shpërndarjes:** Workshop i lehtësuar

**Gjatësia e produktit:** Workshop dy ditor





## **PREPARE FOR PREVENT – schools and academies e-learning module**

### **PËRGATITJA PËR PARANDALIM - module e-learning per shkollat dhe akademite**

**Organizuesi:** [SSS Learning Ltd](#)

SSS Learning Ltd ofron një gamë të plotë të softuerëve për arsimin, shëndetësinë dhe sektorët vullnetarë. Kjo përbëhet nga auditime të fuqishme, vetëvlerësim dhe zgjidhje të të nxënit online për të ndihmuar udhëheqjen dhe menaxhimin dhe për të çuar përpara përmirësimin, duke krijuar pritjet, strukturën dhe llogaridhënien. Secili anëtar i SSS Learning, është i kualifikuar, i vlerësuar me çmime, ka mbi 17 vjet eksperiencë në zhvillimin e softuerit në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar dhe në mbarë botën. Skuadra e shumë kualifikuar e SSS Learning përfshin këshilltarët specialistë të lëndëve që sjellin njohuritë dhe ekspertizën për të siguruar që produktet e SSS Learning janë të cilësisë më të lartë, ndërsa përmbushin plotësisht kërkesat e detyrueshme dhe aktuale të inspektimit.

#### **Qëllimi:**

Duke plotësuar këtë modul, ekipet e udhëheqjes së lartë, drejtuesit, administratorët dhe stafi do të kenë një kuptueshmëri më të mirë.

- Politikat e qeverisjes dhe udhëzime në lidhje me Detyrën e Parandalimit;
- Channel, përfshirë procesin e referimit;
- Faktorët që lidhen me ekstremizmin dhe cenueshmërinë për t'u tërhequr në terrorizëm;
- Praktika më e mirë, përfshirë shembuj me skenarë;
- Protokolle referimi për cilësimet e shkollës / akademisë, përfshihet një model shabllon; dhe



- Si të përmbushni kërkesat e Parandalimit brenda Procesit të Përbashkët të Inspektimit të Ofsted

### **Audienca e synuar:**

Ekipet e Larta Drejtuese të Akademive dhe shkollave, Organet Drejtuese dhe Bordet, Stafi i Shkollës dhe Akademisë (Stafi i Mësimdhënies së Kualifikuar dhe jo-mësimdhënës) dhe Njësitë Referuese të Nxënësve.

### **Përshkrimi:**

Moduli i trajnimit dhe vlerësimit të CPD-së 'Përgatitja për Parandalim' do të sigurojë që të gjithë punonjësit të kuptojnë detyrat e tyre të Parandalimit për të mbrojtur fëmijët dhe për të siguruar kushtet për siguri, dhe që aty ka një kulturë të vigjilencës. Përsa i përket kushteve të edukimit, moduli shqyrton praktikën më të mirë për të siguruar që stafi është i pajisur për të vlerësuar me saktësi cënueshmërinë dhe për të zbatuar siç duhet detyrën e tyre të kujdesit. Moduli është siguruar mirë në internet; nëse ka ndonjë ndryshim në legjislacion ose protokoll gjatë periudhës së licencës 12 mujore, ne do të bëjmë përditësimet e kërkuara dhe do t'ju njoftojmë. Ky kurs është i akredituar nga CPD.

**Metoda e zhvillimit:** e-learning

**Gjatësia e produktit:** Procesi i prezantimit dhe vlerësimit të kursit kërkon rreth 60 min.



## **PËRGATITJA PËR PARANDALIM –Module e-learning për profesionistët e shëndetit**

**Organizuesi:** SSS Learning Ltd

SSS Learning Ltd ofron një gamë të plotë të softuerëve për arsimin, shëndetësinë dhe sektorët vullnetarë. Kjo përbëhet nga auditime të fuqishme, vetëvlerësim dhe zgjidhje të të nxënësve online për të ndihmuar udhëheqjen dhe menaxhimin dhe për të çuar përpara përmirësimin, duke krijuar pritjet, strukturën dhe llogaridhënien. Secili anëtar i SSS Learning, është i kualifikuar, i vlerësuar me çmime, ka mbi 17 vjet eksperiencë në zhvillimin e softuerit në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar dhe në mbarë botën. Skuadra e shumë kualifikuar e SSS Learning përfshin këshilltarët specialistë të lëndëve që sjellin njohuritë dhe ekspertizën për të siguruar që produktet e SSS Learning janë të cilësisë më të lartë, ndërsa përmbushin plotësisht kërkesat e detyrueshme dhe aktuale të inspektimit.

### **Qëllimi:**

- Duke plotësuar këtë modul, profesionistët e shëndetësisë do të kuptojnë:
- Politikën e qeverisjes dhe udhëzime në lidhje me Detyrën e Parandalimit;
- Channel, përfshirë procesin e referimit;
- Faktorët që lidhen me ekstremizmin dhe cënueshmërinë për t'u tërhequr në terrorizëm;
- Praktika më e mirë, përfshirë shembuj me skenarë;
- Protokolle referimi për cilësimet e shëndetit, përfshihet një model shabllon; dhe
- Si të plotësohen kërkesat e Parandalimit në kuadër të detyrës së fëmijës dhe të të rriturve në shërbimin e kujdesit; dhe
- Si të plotësohen kërkesat e Parandalimit kur punoni në një mjedis me shumë agjenci.

### **Audienca e synuar:**

Profesionistët shëndetësorë (përfshirë Mjekët e Përgjithshëm, Infermieret e Përgjithshme të Regjistruar, infermierë praktikues, infermierët e shkollave dhe vizitorët shëndetësorë)

### **Përshkrim:**

Moduli i trajnimit dhe vlerësimit të CPD, 'Përgatitja për Parandalim' do të sigurojë që mjekët dhe profesionistët e shëndetësisë të kuptojnë detyrën e Parandalimit të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve. Bazuar në parametrat e shëndetit, moduli shqyrton praktikën më të mira për të siguruar që stafi është i pajisur për të vlerësuar me saktësi cënueshmërinë dhe për të zbatuar siç duhet detyrën e tyre të kujdesit. Moduli është siguruar mirë në internet; nëse ka ndonjë ndryshim në



legjislaconin ose protokollin gjatë periudhës së licencës 12 mujore, ne do të bëjmë përditësimet e kërkuara dhe do t'ju njoftojmë. Ky kurs është i akredituar nga CDP.

**Metoda e zhvillimit: e-learning**

**Gjatësia e produktit:**

Procesi i prezantimit dhe vlerësimit të kursit kërkon rreth 60 minuta për të përfunduar.

**PREPARE FOR PREVENT - voluntary sector e-learning module**

**PËRGATITJA PËR PARANDALIM – moduli e-learning për sektorin vullnetar**

**Organizuesi: SSS Learning Ltd**

SSS Learning Ltd ofron një gamë të plotë të softuerëve për arsimin, shëndetësinë dhe sektorët vullnetarë. Kjo përbëhet nga auditime të fuqishme, vetëvlerësim dhe zgjidhje të të nxënit online për të ndihmuar udhëheqjen dhe menaxhimin dhe për të çuar përpara përmirësimin, duke krijuar pritjet, strukturën dhe llogaridhënien. Secili anëtar i SSS Learning, është i kualifikuar, i vlerësuar me çmime, ka mbi 17 vjet eksperiencë në zhvillimin e softuerit në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar dhe në mbarë botën. Skuadra e shumë kualifikuar e SSS Learning përfshin këshilltarët specialistë të lëndëve që sjellin njohuritë dhe ekspertizën për të siguruar që produktet e SSS Learning janë të cilësisë më të lartë, ndërsa përmbushin plotësisht kërkesat e detyrueshme dhe aktuale të inspektimit.

**Qëllimi:**

- Duke plotësuar këtë modul, administratorët e besuar, menaxherët, udhëheqësit e ekipit, stafi dhe punëtorët e projektit do të kenë një kuptim me:
- Politikat e qeverisjes dhe udhëzimet në lidhje me Detyrën e Parandalimit;
- Channel, përfshirë procesin e referimit;
- Faktorët që lidhen me ekstremizmin dhe cenueshmërinë për t'u tërhequr në terrorizëm;
- Praktika më e mirë, përfshirë shembujt me skenarë;
- Protokollet referuese për mjediset e sektorit vullnetar, përfshihet një model shabllon;
- Si të plotësohen kërkesat e Parandalimit në kuadër të detyrës së fëmijës dhe të të rriturve të shërbimit të kujdesit; dhe



- Si të përmbushni kërkesat e Parandalimit kur punoni në një mjedis me shumë agjenci.

### **Audienca e synuar:**

Administratorët e besuar, menaxherët, udhëheqësit e projektit, personeli dhe vullnetarët.

### **Përshkrim:**

Moduli i trajnimit dhe vlerësimit CPD "Përgatitja për Parandalimin" do të sigurojë që ata të cilët punojnë brenda sektorit vullnetar të kuptojnë detyrat e Parandalimit të mbrojtjes së fëmijëve dhe të rriturve dhe për të siguruar kushtet për siguri, dhe që aty ka një kulturë të vigjilencës. Bazuar në parametrat e vullnetarizmit, moduli shqyrton praktikën më të mirë për të siguruar që stafi është i pajisur për të vlerësuar me saktësi cënueshmërinë dhe për të zbatuar siç duhet detyrën e tyre të kujdesit. Moduli është siguruar mirë në internet; nëse ka ndonjë ndryshim në legjislacionin ose protokollin gjatë periudhës së licencës 12 mujore, ne do të bëjmë përditësimet e kërkuara dhe do t'ju njoftojmë. Ky kurs është i akredituar nga CPD.

**Metoda e zhvillimit:** e-learning

### **Gjatësia e produktit:**

Procesi i prezantimit dhe vlerësimit të kursit kërkon rreth 60 minuta për të përfunduar.



## NJË PËRGJIGJE E KOMUNITETIT PËR EKSTREMIZMIN

**Organizuesi:** [Avon and Somerset Constabulary](#)

**Qëllimi:**

- a) Të ofrojë një reagim nga myslimanët e zakonshëm në Bristol për narrativën e rekrutimit të përdorur nga ISIS dhe Al Qaida
- b) Të ofrojë informacione të sakta mbi Islamit dhe Muslimanët tek audiencia jo-specialiste. Qëllimi nuk është të predikojë mesazhin e Islamit, por të tregojë thelbin e Islamit dhe praktikën e besimit mysliman.
- c) Të ndihmojë në ndërtimin e besimit brenda komuniteteve dhe partneriteteve.

**Audiencia e synuar:**

Stafi i vijës së parë, duke përfshirë policinë, shërbimet sociale, shërbimin e provës, arsimin, stafin shëndetësor dhe komunitetet lokale.

**Përshkrimi:**

Ky film fokusohet tek anëtarët e komunitetit mysliman lokal të Bristol-it dhe në reagimin e tyre kundrejt ekstremizmit.

Filmi u jep komuniteteve një shans për të diskutuar mbi besimin e tyre dhe për të nxjerrë në pah dhe kuptuar reagimin e anëtarëve të zakonshëm të komuniteteve myslimane për narrativën e rekrutimit të përdorur nga ISIS dhe Al Qaeda.

Është një mjet unik i projektuar për të sfiduar islamofobinë dhe për t'i dhënë audiencës një mundësi për të kuptuar natyrën e vërtetë të besimit islam dhe çfarë do të thotë për ata që duan ta mbrojnë atë nga ekstremistët.

**Metoda e zhvillimit:**



Platformë online që mundëson shikimin e videove  
**Gjatësia e produktit:** 24:46

### SAFE CAMPUS COMMUNITIES

### KOMUNITETE TE SIGURTA NE KAMPUS

**Organizuesi:** [Universities UK](#)

**Audienca e synuar:** Arsimi i Lartë (Universitetet)

#### Përshkrimi

Portali i Safe Campus Communities ofron qasje dhe lidhje me një sërë informacionesh dhe burimesh për Institucionet e Arsimit të Lartë, duke përfshirë:

- Dokumente udhëzues të tilla si “Folësit e Jashtëm në Institucionet e HE” dhe “Marrëdhëniet e Mira në Kampus”;
- Shfrytëzimi e një sërë rastesh studimi duke theksuar se si institucionet e Arsimit të Lartë reagojnë dhe menaxhojnë rreziqe dhe ngjarje të caktuara në kampus - shembujt përfshijnë menaxhimin e ngjarjeve me rrezikshmëri të lartë dhe si Koordinatorët Rajonalë të Parandalimit të BIS bëjnë të pamundurën.
- Lidhje me dokumentet përkatëse kërkimore;
- Lidhje me dokumentet e qeverisë duke përfshirë Strategjinë e Parandalimit 2011 dhe Aktin e Sigurisë dhe Kundër Terrorizmit;
- Informacion mbi kontaktimin e Koordinatorëve Rajonalë të Parandalimit të BIS-it; dhe
- Detaje për evente dhe trajnime të ardhshme.

**Metoda e zhvillimit:** Përmbajtja në portal.

**Gjatësia e produktit:** N / A



## Fjalor i termave:

**"Ekstremizmi"** përkufizohet në strategjinë e Parandalimit 2011, si opozitë vokale ose aktive ndaj vlerave themelore britanike, duke përfshirë demokracinë, sundimin e ligjit, lirinë individuale, respektin e ndërsjellë dhe tolerancën e besimeve dhe bindjeve të ndryshme. Ne gjithashtu përfshijnë në përkufizimin tonë të ekstremizmit thirrjet për vdekjen e anëtarëve të forcave tona të armatosura, qoftë në vend ose jashtë shtetit.

**"Ndërhyrje"** janë projekte që synojnë të devijojnë njerëzit që po tërhiqen në veprimtari terroriste. Ndërhyrjet mund të përfshijnë mentorimin, këshillimin, mbështetjen teologjike, inkurajimin e angazhimit qytetar, zhvillimin e rrjeteve mbështetëse (strukturat familjare dhe kolegjëve) ose ofrimin e shërbimeve kryesore (arsim, punësim, shëndetësi, financë ose strehim).

**'Ekstremizmi jo i dhunshëm'** është ekstremizmi, siç përcaktohet më sipër, i cili nuk shoqërohet me dhunë.

**'Parandalimi'** në kontekst të këtij dokumenti nënkupton zvogëlimin ose eliminimin e rrezikut të përfshirjes së individëve në terrorizëm. Parandalimi përfshin, por nuk kufizohet vetëm në identifikimin dhe referimin e atyre që rrezikojnë të futen në terrorizëm me ndërhyrje të përshtatshme. Këto ndërhyrje synojnë t'i devijojnë njerëzit e prekshëm nga radikalizimi.

**"Radikalizimi"** i referohet procesit me të cilin një person fillon të mbështesë terrorizmin dhe ideologjitë ekstremiste të lidhura me grupet terroriste.

**'Mbrojtja'** - Safeguarding është procesi i mbrojtjes së personave të prekshëm, qoftë nga krimi, forma të tjera të abuzimit ose (në kontekst të këtij dokumenti) nga të qenit të tërhequr në veprimtari terroriste. Përcaktimi aktual i Mbretërisë së Bashkuar për **"terrorizmin"** është dhënë në Aktin e Terrorizmit 2000 (TACT 2000). Në përmbledhje kjo përcakton terrorizmin si një veprim që rrezikon ose shkakton dhunë serioze një ose shumë personave; shkakton dëme serioze të pronës; ose ndërhyrje serioze ose prish sistemin elektronik. Përdorimi ose kërcënimi duhet të krijohet për të ndikuar qeverinë ose për të frikësuar publikun dhe bëhet me qëllim të avancimit të një shkakut politik, fetar ose ideologjik.

**"Vepra të lidhura me terrorizmin"** janë ato vepra (të tilla si vrasja) të cilat nuk janë vepra penale në legjislacionin terrorist, por që gjykojnë të kryera në lidhje me terrorizmin.





**“Cenueshmëria”- vulnerabiliteti** përshkruan gjendjen e të qenit i lehtë të çenohet; i vështirë për t’u mbrojtur; i hapur ndaj sulmit moral apo ideologjik. Në Parandalim, fjala përshkruan faktorët dhe karakteristikat që lidhen me të qenit të cenueshëm ndaj radikalizimit.

**© Crown Copyright 2016**

***Teksti në këtë dokument (me përjashtim të Armës Mbretërore dhe logove të departamenteve ose agjencive të tjera) mund të riprodhohet pa pagesë ose në çdo format ose medium, me kusht që të riprodhohet me saktësi dhe të mos përdoret në një kontekst mashtrues. Materiali duhet të njihet si autoriteti i kurorës dhe titulli i dokumentit të specifikuar. Ku kemi identifikuar ndonjë material të palës së tretë, ju duhet të merrni leje nga mbajtësit e të drejtave të autorit në fjalë. ISBN: 978-1-78655-061-3***